

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOOËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“2E NK PLAN” SH. P. K.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Në Tiranë, sot më datën 09.05.2022, Ortakët e poshtëshënuar vendosën të krijojnë shoqërinë “ 2E NK_PLAN ” shpk:

1.KLEDI GJINI, i datëlindjes 23.11.1978 ,me numër personal H81123051R lindur dhe banues ne Lushnje, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

2.XHOEL BEHARI, i datëlindjes 09.03.2000,me numër personal K00309063P lindur dhe banues në Fier, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Kultivimi, mbjellja, rritja, vjelja, përpunimi, importi, eksporti i arrorëve, ullirit, shegës, arra, lajthi, bajame.
- Marrja me qera apo me çfardo lloj forme tjetër të parashikuar nga ligji I tokave bujqësore me qëllim kultivimin e arrorëve, ullirit, shegës, arra, lajthi, bajame si dhe çdo produkti ushqimor , fruta, perime, zarzavate, erëza, etj. Kultivimi, përpunimi, import-eksport me dhuricë dhe pakicë e çdo produkti ushqimor , lëndë të parë si dhe çdo nënprodukti ushqimor të çdo lloj
- Prodhim primar produktesh ushqimore
- Prodhim dhe përpunim të lëndës së parë ushqimore dhe eksportimin etyre në vende te ndryshme, Brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Eksport-import të çdo makinerie, produkti, fare, fidani, kimikate apo pajisje që kanë lidhje me aktivitetin e sipërpërmendur, si dhe çdo material tjetër të nevojshëm që lidhet me të.
- Prodhim dhe shitje të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (fotovoltaik, eolike, energjia diellore).



- Çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3:
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Neni 4:
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresë Rruga: Lami Monka” Zona Kadastrale nr.8534, Pasuria nr..2/43, Fier.

Shoqëria mund të krijojë qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë shtetit në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

KREU II
Kapitali

Neni 5:
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është caktuar në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues KLEDI GJINI, zotëron 75 % të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 75.000 lekë
2. Ortaku themelues XHOEL BEHARI , zotëron 25 % të kapitalit themeltar ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 25.000 lekë

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar



për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të asamblese së përgjithshme njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblese së përgjithshme të thirur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit temeltar me një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, nëse rregullimi është bërë ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 7: Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organi vendimarrës

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së

veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

3. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9:

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10:

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më

vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11: Administrimi

Administratoret e shoqërisë janë Z.KLEDI GJINI, i datëlindjes 23.11.1978 ,me numër personal H81123051R lindur dhe banues ne Lushnje, i cili emërohet në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.Administratori është i çliruar nga kompetencat per rregjistrimin fillestar te shoqerise .

Tagrat e perfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij, njoftohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Znj .Leonora Gjeka e datëlindjes 07.01.1964 , me numer personal G45107144M lindur ne Fier për një afat 5 vjecar.

Administratorja është e çliruar nga kompetencat dhe pergjegjesia e marrdhenieve me institucionet bankare si dhe marrdhenieve verbale me institucion tatimor.Administratorja është e autorizuar eskuzive per regjistrimin fillestar te shoqerise .

Administratoret ne venci nuk do funksionojne si organ kolegjal .

Neni 12: Kompetencat e administratorëve

1. Administratoret kane të drejtë të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4.Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.ne raste kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat

kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 13:

Përgjegjësitë e administratorëve

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja e përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratorët detyrohen:

1.a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave

të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

KREU IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 14:

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor. Përfundimisht, viti financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbaron në 31 dhjetor.

Neni 15:

Ekspertët

Experti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë I ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të priset në çdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Ne kete rast asambleja e përgjithshme merr vendim me shkrim me te cilen parashikon menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre pre tij emrin e likujdatorit dhe emeratesen "Shoqeri ne likujdim e siper". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga asambleja e përgjithshme. Nese asambleja e përgjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likujduesve brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates per te caktuar nje likujdues.

Neni 17: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 18 Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaket e shoqerise "2E NK PLAN" " SH. P. K

Kledi GJINI

Xhoel BEHARI

8

